



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1128/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Milena Đeric dhe Adnan Konushevi anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të Thyerjes së Heshtjes zgjedhore, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë:

VE N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa Anr.1128/2021 e datës 14.11.2021, e paraqitur nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale. Ndërsa subjektit politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 300.00 (treqind euro), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021.

II. DETYROHET Subjekti Politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) që gjobën e shqiptuar si në pikën **-I-** të dispozitivit të këtij vendimi ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 14.11.2021, ka pranuar ankesën Anr.1128/2021, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, me të cilën ndër të tjera pretendon se me datën 13.11.2021 ditën e shtune gjatë heshtjes zgjedhore aktivisti dhe mbështetësi i subjektit politik AAK Florim Turkaj ka thyer heshtjen zgjedhore duke postuar ne rrjetin e tij social Diçka e mire po vjen per Istogun Voto Beke Berisha 121 veprim ky qe sipas parashtresës te ankeses është në kundërshtim nënin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së. Më tej parashtresuesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i, që subjekti politik AAK, të sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.

Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës ka bashkangjitur dy fotografi të printuara lidhur me thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Në përgjigje në ankesë të datës 15.11.2021, subjekti politik AAK konsideron se pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës janë jo të drejta, për faktin se nga provat e ofruara si dëshmi nuk mund të vërtetohet në mënyrë të qartë data dhe ora e saktë e postimit, pra nuk dihet data kur është bere postimi, po ashtu i njëjti thekson se personi në fjale ehte i panjohur dhe nuk ka kurrfarë pozite në AAK dhe nuk është pjese e strukturave të AAK-se. Andaj propozon që ankesa të refuzohet e pabazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shqyrtimi të shkresave të lëndës ka konstatuar se subjekti politik Subjekti Politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog,- përkatësisht aktivistet dhe simpatizantët e saj, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin social “Facebook” ka bërë fushatë zgjedhore ashtu që përmes rrjetit social “Facebook” kanë bërë një postim ku shihet thirrja e cila i behet votuesve për të votuar për kandidatin e AAK-së për kryetar të Komunës së Istogut Bekë Berisha, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) e LZP-së, e cila përcakton *“Njëzet e katër (24) orë para hapjes së Qendrës të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, sepse postimi i bërë nga Florim Turkaj, ishte i publikuar më datë 13.11.2021 gjatë heshtjes zgjedhore dhe i njëjti ishte ende prezent në faqen e përdoruesit nga vetë përdoruesi në fjalë në kohën e cekur si në ankesë por edhe në kohën e hetimit të PZAP-it.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, gjithashtu si rrethanë paneli mori faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme dhe ka marrë mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore dhe faktin se subjekti politik në fjalë ka bërë përpjekje që të njoftoj kandidatët e saj lidhur me respektimin e legjislacionit në fuqi me qëllim të evitimit të shkeljeve gjatë heshtjes zgjedhore, e të cilat rrethana kanë ndikuar në lehtësimin e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me

rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi, nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ *Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.*”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekura në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1128/2021 më datën 15.11.2021

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.